



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e aseteve me likuidim Nr. 47 - Njësia e vendosur në tender Nr. 14

KB 1 Maji Depoja në Stanishor

Emri i NSh.-së	Kooperativa Bujqësore “1 MAJ”, (“Ndërmarrja”), FI-401/85, dt. 03.09.1985.
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Me 12 Qershor 2019, nga 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Depozita e Ofertës	Euro 5,000
Vendndodhja e Aseteve	Aseti i ofruar për shitje ndodhet në fshatin Stanishor, në Komunën e Novobërdës.
Përshkrimi i Aseteve	Prona që ofrohet për shitje është vetëm Depoja me sipërfaqe prej 265,42m ² , e cila është e ndërtuar në parcelën me nr. 01056/1 ZK Stanishor, KK Novobërde. Kjo parcelë nuk është në shitje. Aseti, objekti ofrohet për shitje duket u bazuar në Deklaratën e ish-Drejtorit me dt. 18/08/2017 si dhe kontratën e qirasë të dt. 16.10.2017, me të cilën vërtetohet posedimi i objektit nga Ndërmarrja Shoqërore që nga viti 1986.
Ndërtesat dhe tokat	N.Sh. “KB 1 MAJ “ Stanishor nuk e ka të regjistruar pronësinë e asetit/objekti në regjistrin e të drejtave të paluajtshmërisë në ZK Novobërdës. Objekti është i ndarë në dy pjesë/hyrje: Pjesa e parë (H-1) e këtij objekti është me sipërfaqe prej 136,57m ² , matjet janë bërë nga muret e brendshme të objektit, në këtë hyrje gjendet edhe një makineri për përpunimin e koncentratit për nevoja bujqësore, ndërsa Pjesa e dytë (H-2) e këtij objekti është me sipërfaqe prej 128,85m ² , matjet janë bërë nga muret e brendshme të objektit, kjo pjesë është dhënë me qira nga Autoriteti i Likuidimit. Sipas gjendjes faktike, objekti përmes parkingut ka qasje në rrugë publike; Objekti ka konstruksion të ndërtimit nga materiali i fort, ka vjetërsi të konsideruar, mirëpo është funksional. Pjesë e kësaj shitje nuk është toka por vetëm objekti.
Shfrytëzuesit	Pjesa e Dytë (H-2) e objektit me sipërfaqe prej 128,85 m ² , është e dhënë me qira dhe shfrytëzohet nga Shkolla e Muzikes.

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Përshkrimi i Aseteve tjera


Detyrimet që do të barte

Orto-foto ose informata të tjera për asetet në shitje

Pjesë e kësaj shitje është një makineri për përpunimin e koncentratit si dhe vetura e tipit LADA, këto pajisje nuk janë funksionale.

Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek pronari i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.

KB 1 Maji Depoja në Stanishor



Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorë

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1105, 2055

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Agim Ramadani Nr: 23
10000 Prishtinë/ Pristina, Kosova

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org